

UDHËZIM
Nr. 4, datë 24.4.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 338/3, DATË 10.3.2006 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 787, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të pikës 38 të vendimit nr. 787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 338/3, datë 10.3.2006 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bëhen këto ndryshime:

1. Në seksionin I, pas pikës 10 shtohet pika 11.

“11. Për anëtarin e familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, nuk i llogaritet masa e ndihmës ekonomike si individ në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

Për shembull:

a) Familja është me dy anëtarë, kryefamiljari është person me aftësi të kufizuara (i verbër, invalid pune, para dhe tetraplegjik apo fizik dhe mendor), anëtari i dytë është person në moshë pune, atëherë llogaritet masa e ndihmës ekonomike për këtë familje do të jetë vetëm për anëtarin e dytë, pra masa e ndihmës ekonomike që do të përfitohet është 600 lekë në muaj.

b) Familja është me tre anëtarë, kryefamiljari, një anëtar në moshë pune dhe një anëtar nën moshë pune. Anëtari në moshë pune është person me aftësi të kufizuara (i verbër, invalid pune, para dhe tetraplegjik apo fizik dhe mendor). Masa e ndihmës ekonomike për anëtarin në moshë pune nuk llogaritet në strukturën e kësaj familjeje, pra administratori shoqëror për këtë familje me tre anëtarë do të llogarisë 2600 lekë+700 lekë=3.300 lekë si ndihmë ekonomike.”.

2. Seksioni V.1 shfuqizohet.

3. Pika 17 e seksionit XI zëvendësohet me paragrafin:

“17. Ndihma ekonomike e familjes përfituese tërhiqet pranë sporteleve të bankave/Postës Shqiptare nga bashkëshortët/individët që do të administrojnë paratë, sipas deklarimit në modularin 2”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera